



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 9588 Prot
Shkodër, më 3 . 06 . 2019

BID
SHKODËR

SHOQATA
BID SHKODËR

Nr. 16 Prot
Shkodër, më 5 . 6 . 2019

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë ___/___/2019 ndërmjet palëve si mëposhtë vijon:

1. **Bashkia Shkodër** e përfaqësuar nga **Znj. Voltana Ademi** në cilësinë e Titullares të Institucionit me adresë Rr. "13 Dhjetori", këtej e tutje e cilësuar si Bashkia, dhe
2. **Shoqata "BID Shkodër"** e përfaqësuar nga **Z. Altin Salih**, në cilësinë e Kryetarit të Bordit me adresë në Rr. "13 Dhjetori" me kartë identiteti G30923042L dhe certifikatë regjistrimi NIPT-L36506191K, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendim Nr. 3279/2, datë 22/02/2016.

Baza ligjore:

- Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar,
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 918, dt. 4.10.2013 "Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet bashkive Shkodër, Korçë, Berat, Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim dhe Këshillit të Ministrave të R.Sh-së, për zbatimin e projektit "Zonë për Zhvillimin e Biznesit - ZZHB",
- Vendimit të Këshillit të Bashkisë Shkodër Nr.13 datë 12.03.2012, "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Fondacionit Shqiptaro Amerikan për Zhvillim (AADF)",
- Vendimit nr. 3279/2, dt.22.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për miratimin e ndryshimeve në statutin e organizatës "BID Shkodër".

- Vendimi i Këshillit të Bashkisë Shkodër, nr. 82, datë 20.12.2018, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër",
- Vendim i Këshillit të Bashkisë Shkodër me nr. 1 datë 22.01.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër".

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është:

- Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblihen nga bizneset e zonës së veprimtarisë tek shoqata "BID Shkodër" për zhvillimin e aktiviteteve vjetore të programuara sipas buxhetit të shoqatës të miratuar nga Bordi Drejtues i saj për vitin 2019.
- Përfshirja nga tarifa e përkohshme për zënie e hapësirës publike të "Rr. 28 Nëntori – Rr. 13 Dhjetori - Rr. Kolë Idromeno" për aktivitetet e organizuara nga kjo shoqatë me qëllim promovimin e produktit territorial.

Neni 2 Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje lidhet për vitin 2019. Efektet financiare fillojnë nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2019.

Neni 3 Qëllimi

Kjo marrëveshje ka për qëllim vazhdimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës "BID Shkodër" në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonën "Rr.13 Dhjetori - 28 Nëntori - 13 Dhjetori".

Shoqata "BID Shkodër" ka qëllim të sigurojë një zonë më të pastër, më të sigurtë dhe tërheqëse duke synuar sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin e programeve dhe shërbimeve publike shtesë për t'iu përshtatur nevojave të biznesit duke krijuar një zonë biznesi që ka aftësi të konkurrojë përmes organizimit të ngjarjeve kulturore, argëtuese, sensibilizuese me qëllim tërheqjen e kalimtarëve të rregullt por edhe atyre potencial.

Kushtet e marrëveshjes:

Neni 4 Rolet dhe përgjegjësitë e shoqatës "BID Shkodër"

1. Shoqata e bizneseve "BID Shkodër" ofron shërbime shtesë, mirëmbajtje dhe pastrimi të zonës BID, aktivitete kulturore dhe argëtuese, konsulencë profesionale bizneseve të zonës "Rr.13 Dhjetori - 28 Nëntori - Rr.Kolë Idromeno" me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit në këtë zonë.
2. Vetëm bizneset që ushtrojnë aktivitetin në zonën BID dhe janë anëtare të kësaj shoqate, në rast se shfaqin interesin e tyre për të shfrytëzuar hapësirën publike të kësaj zone, duhet të paraqesin në ZIN të Bashkisë Shkodër, formularin tip të aplikimit (bashkëlidhur kësaj marrëveshje) të plotësuar dhe të miratuar nga shoqata "BID Shkodër", në të cilin pohohet që pala e interesuar bie dakort të respektojë rregulloren mbi shfrytëzimin e hapësirave publike sipas vendimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës nr. 227, datë 13.09.2016 mbi "Plotësimin, unifikimin dhe arredimin urban të rrugës "13 Dhjetori - 28 Nëntori - Kolë Idromeno".
3. Shoqata e bizneseve "BID Shkodër" duhet të paraqesë pranë Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit të Bashkisë Shkodër, sa herë paraqet kërkesën për lëvrimin e fondit, një raport narrativ mbi ecurinë e shërbimeve të ofruara nga kjo shoqatë për përfituesit-bizneset e zonës BID, problematikat e veçanta për periudhën e raportimit, aktivitetet e zhvilluara, aspekte të veçanta, etj.
4. Për lëvrimin e fondit të vënë në dispozicion në buxhetin e Bashkisë në përputhje me kalendarin e zbatimit të planit buxhetor të shoqatës së bashku me raportin e aktivitetit të kryer, shoqata duhet të paraqesë, dokumentacionin si mëposhtë:
 - a. Listpagesa të punonjësve në paga bruto dhe neto të shoqëruar me urdhër pagesa të konfirmuara nga banka.
 - b. Listpagesa të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim i të ardhurave nga punësimi, Formulari E-Sig e konfirmuar nga banka.
 - c. Në rastet e blerjes së materialeve, realizimit të aktiviteteve kulturore e argëtuese për likuidimin, BID duhet të sjellë dokumentacionin sipas procedurës së përcaktuar nga shoqata.

Dokumentacioni do të përcillet sëbashku me gjurmën e auditit nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit tek Drejtoria e Financës për likuidim.

Neni 5

Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër

Bashkia e Shkodrës, sipas buxhetit të saj për vitin 2019 të miratuar me VKB-në, nr. 82 datë 20.12.2018, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2019-2021 të Bashkisë Shkodër", ka miratur fondin për Projektin "BID Shkodër", si një mundësi për përmirësimin e klimës së biznesit të kësaj zone.

Fondi që do të lëvrohet në zbatim të kësaj marrëveshje është 1.600.000 lekë, i ndarë si më poshtë:

- a. Vlera monetare e pagave 528,888 lekë.

- b. Vlera monetare e sigurime shoqërore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi 213,324 lekë.
- c. Vlera monetare e kontratës së shërbimit për pastrimin e zonës BID 480,000 lekë.
- d. Vlera monetare e aktiviteteve kulturore, argëtuese (BID Art Street dhe Festa e fundvitit) 377,788 lekë.

Vlerat monetare të zërave të mësipërm (a-d) janë të përcaktuar në buxhetin e miratuar nga vendimi nr. 1, datë 03.01.2019 të Bordit Drejtues të shoqatës së bizneseve "BID Shkodër", ku një kopje e buxhetit të miratuar nga kjo shoqatë do i bashkëngjitet kësaj marrëveshje.

Bashkia Shkodër do të:

1. Në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.1 datë 22.01.2016, "Mbi miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër", i ndryshuar, Bashkia Shkodër do të përjashtojë nga tarifa e përkohshme për zënie e hapësirës publike të "Rr. 28 Nëntori – 13 Dhjetori - Rr.Kolë Idromeno" për aktivitetet e organizuara nga kjo shoqatë apo në partneritet me Bashkinë Shkodër me qëllim promovimin e produktit territorial.
2. Monitorojë dhe vlerësojë projektin "BID Shkodër".
3. Do të vazhdojë të ketë një përfaqësues të këtij institucioni në bordin drejtues të kësaj shoqate për të ndjekur mbledhjet e bordit, veprimtaritë dhe çdo aktivitet tjetër.

Neni 6

Mënyra e lëvrimit të fondit

Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Shkodër do të kryejë likuidimin e vlerës totale në vlerën prej 1 600 000 lekë përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje nga fondi i parashikuar dhe miratuar në paketën fiskale në llogari të Shoqatës "BID Shkodër" me IBAN, AL 822 135 1019 000 000 000 108 49994 në Bankën Societe General Albania – dega Shkodër.

Lëvrimi i shumës do të bëhet pas dorëzimit të dokumentacionit mbështetës dhe verifikimit të tij nga Bashkia Shkodër për: paga, sigurime shoqërore, tatim burim, kontratën e shërbimit mbi pastrimin, aktivitetet kulturore e argëtuese për çdo periudhë mujore nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje deri në përfundim të saj.

Fondi i miratuar për këtë qëllim është në zbatim të marrëveshjes nr. 729, datë 27.02.2012 në kuadër të zhvillimit të projektit "Zona për Zhvillimin e Biznesit", paragrafi IV do të transferojë tarifën e mbledhura nga bizneset e Rr. "28 Nëntori", "13 Dhjetori", "Kolë Idromeno" tek Shoqata "BID Shkodër", të arkëtuara gjatë vitit 2019, e konfirmuar nga Drejtoria e të Ardhurave pranë "Bashkisë Shkodër" deri në shumën e miratuar.

Neni 7

Zgjidhja e menjëherëshme e marrëveshjes

Marrëveshja zgjidhet menjëherë kur:

1. Nuk respektohet rregullorja mbi shfrytëzimin e hapësirës Rr. "28 Nëntori", "13 Dhjetori", "Kolë Idromeno" sipas vendimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës nr. 227, dt. 13.9.2016 mbi "Plotësimin, unifikimin dhe arredimin urban të rrugës "13 Dhjetori - 28 Nëntori - Kolë Idromeno";
2. Nuk paraqitet raporti narrativ mbi ecurinë e shërbimeve të ofruara nga kjo shoqatë për përfituesit – bizneset e zonës BID;
3. Në rast të ndotjes në mënyrë të përsëritur të zonës BID me mbetje nga aktiviteti i këtyre bizneseve.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, do të zgjidhet me mirëkuptim nga palët, në rast të kundërt për zgjidhjen e mosmarrëveshjes palët mund t'i drejtohen Gjykatës kompetente.

Kjo marrëveshje hartohet në katër (4) kopje origjinale, e cila pasi u lexua nga palët, u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

PËR
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR

Voliana Ademi
Voliana Ademi

PËR
SHOQATËN BID

KRYETAR I BORDIT

Altin Salih

Konceptoi: *[Signature]* _____ (Specialist)

Pranoi: _____ (Përgjegjësi)

Miratoi: *[Signature]* _____ (Drejtori)

Konfirmoi: E. Koliqi (Zv/Kryetar)

Shkodër, më ____ / ____ / ____.

FORMULAR TIP

Lënda: Kërkesë për aplikim për hapësire publike në zonën BID

Nr.	Përshkrimi	
1	Emri i Biznesit	
2	Përfaqësues Biznesi	
3	NIPT-i	
4	Adresa	
5	Sipërfaqja e kërkuar	
6	Unë, _____, shpreh gatishmërinë time për të shfrytëzuar hapësirën publike sipas vendimit nr. 227, datë 13.09.2016 të Institutit të Monumenteve të Kulturës mbi "Plotësimin, unifikimin dhe arredimin urban të rrugës "13 Dhjetori - 28 Nëntori - Kolë Idromeno"	
7	Në rast se shfrytëzimi i hapësirës publike në "Rr.Kolë Idromeno" nuk do të bëhet sipas sipas vendimit nr.227, datë 13.09.2016 të Institutit të Monumenteve të Kulturës mbi "Plotësimin, unifikimin dhe arredimin urban të rrugës "13 Dhjetori - 28 Nëntori -Kolë Idromeno", shoqata BID Shkodër do bëjë njoftimin përkatës në Bashkinë Shkodër. <input type="checkbox"/> Jam dakort <input type="checkbox"/> Nuk jam dakort	

Aplikuesi: _____

(Emër/Mbiemër/Firmë)

Kërkesa për aplikim për hapësirë publike ne Rr.Kole Idromeno e përfaqësuesit të biznesit _____ aprovet nga shoqata "BID Shkodra". Ky aplikim do ti kalojë për shqyrtim të mëtejshëm Zyrës së Urbanistikës pranë Bashkisë Shkodër.

Administratori

(Emër/Mbiemër/Firmë/Vulë)